



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE**

Nr. 43/14 Prot.

Tiranë, më 17.11 2022

V E N D I M

Nr. 149, datë, 17. 11. 2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Rasim Guzi, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.892/5 ex 21 datë 23.09.2022, “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Rasim Guzi”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numer protokolli 43, datë 23.09.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr.115, datë 07.10.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Rasim Guzi, për kryerjen e shkeljes disiplinore në formën : “veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”, parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, neni 33, pika 2, gërma “a”.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për propozimin për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Rasim Guzi, gjatë hetimit të 21 proçedimeve penale, dhe konkretisht në:

Procedimi penal **nr. 1552**, datë 31.07.2019 . Procedimi penal **nr. 2191**, datë 30.09.2019,
 Procedimi penal **nr.1515**, datë 31.07.2019, Procedimi penal **nr.1528**, datë 31.07.2019,
 Procedimi penal **nr.1536**, datë 31.07.2019, Procedimi penal **nr.1537**, datë 31.07.2019,
 Procedimi penal **nr.1525**, datë 31.07.2019, Procedimi penal **nr.1544**, datë 31.07.2019,
 Procedimi penal **nr.1539**, datë 31.07.2019, Procedimi penal **nr. 386**, datë 02.03.2020,
 Procedimi penal **nr.763**, datë 16.04.2019, Procedimi penal **nr.993**, datë 23.06.2020,
 Procedimi penal **nr.2136**, datë 24.10.2019, Procedimi penal **nr.1521**, datë 31.07.2019,
 Procedimi penal **nr.1532**, datë 31.07.2019, Procedimi penal **nr.1746**, datë 21.10.2020,
 Procedimi penal **nr.82**, datë 16.01.2020, Procedimi penal **nr.140**, datë 22.01.2020,
 Procedimi penal **nr. 127** , datë 29.01.2021, Procedimi penal **nr.1743**, datë 21.10.2020,
 Procedimi penal **nr.1047**, datë 19.06.2018,

Nga aktet që u administruan gjatë seances dëgjimore per proçedimin disiplinor, u provua se:

2.1 Prokuroria e Përgjithshme, mbi bazën e Urdhërit Nr.61 datë 02.06.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ushtruar kontroll mbi treguesi e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vitin 2021.

Objekti i kontrollit ishte ligjshmëria e veprimeve hetimore të oficerëve të Policisë Gjyqësore në;

- Procedimet penale të regjistruara nga data 01.05.2020 – 31.05.2021 dhe ato të mbartura nga vitit 2019, për të cilat është vendosur pushimi i procedimit penal, janë dërguar për gjykim, apo nuk kanë përfunduar hetimet dhe janë mbartur për vitin 2021.
- Mosfillimet e procedimeve penale të vendosura për materialet kallëzuese/referuese të regjistruara prej datës 01.05.2020 – 31.05.2021.
- Disiplina në punë.

Nga ana e grupit të punës, në përfundim të procesit të kontrollit të ushtruar për cdo oficer të policisë gjyqësore, është përpiluar raporti përfundimtar përmbledhës në të cilat janë pasqyruar problematikat si në nivel organizativ të punës së seksionit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ashtu dhe në nivel individual për secilin oficer të policisë gjyqësore.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar për periudhën objekt inspektimi u konstatua se, ne hetimin e procedimeve penale të hetuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi , në disa prej tyre janë lejuar zvarritje në hetim dhe nuk janë respektuar afatet e caktuara në urdhërin e prokurorit të çështjes, për kryerjen e veprimeve hetimore.

Zvarritjet e veprimeve hetimore janë të pajustificuara dhe në shkelje të dispozitave ligjore të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat rregullojnë dhe disiplinojnë hetimin dhe afatet e tij.

2.2. Sikurse rezulton nga aktet e administruara në seancën dëgjimore, në datën 31.07.2019, Prokuroria Elbasan ka regjistruar procedimin penal **nr. 1552**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar gjyqit në datën 20.01.2021

Për këtë procedim penal konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsiston në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara, nga prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi për një vit e gjysëm.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjitrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi për gati 6 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjera. Nga aktet e dosjes rezulton se nga oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi janë kryer vetëm disa veprime hetimore, një shkresë për informacion drejtuar Bashkisë Elbasan dhe vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020. Mandej, për gati katër muaj, deri në datën 21.01.2021 nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 4 muaj.

2.3. Në datën 30.09.2019, është regjistruar procedimi penal nr. 2191, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, zgjidhur me marrëveshje datë 25.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara, nga prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi për një vit e tre muaj.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjitrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi për gati 5 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjera. Nga aktet e dosjes rezulton se nga oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi janë kryer vetëm disa veprime hetimore, vendim për kryerjen e ekspertimit teknik, njoftim përfundim hetimesh dhe pyetje e të pandehurit. Nga muaji shtator 2020, kur është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik, deri në datën 21.01.2021, për gati katër muaj, nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 4 muaj.

2.4. Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1515**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 08.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit procedimit penal 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe dosja është mbajtur pa veprime nga prokurori i çështjes. Prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjistrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi për gati 5 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjera. Në dt.28.09.2020 është kryer veprimi i parë hetimor nga oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi, marrje deklarimi. Ndërsa në datën 15.09.2020 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-ndërtimi. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në muajin dhjetor 2020 nuk është kryer asnjë veprim.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 3 muaj.

2.5. Në datën 31.07.2019 është regjistruar procedimi penal nr.1528, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar për gjykim dt. 06.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit procedimit penal 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe dosja është mbajtur pa veprime nga prokurori i çështjes. Prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjistrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi për gati 5 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjera. Në datën 15.09.2020 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-ndërtimi. Ky veprime është kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në muajin dhjetor 2020 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për më shumë se 3 muaj.

2.6 Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1536**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a I Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 17.03.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare nga momenti i regjistrimit procedimit penal 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe dosja është mbajtur pa veprime nga prokurori i çështjes. Prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjistrimit të procedimit

penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi mbi 6 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjerë. Në datën 15.09.2020 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-ndërtimi, në datën 30.09.2020 i është drejtuar Bashkisë Elbasan me shkresë për marrje informacioni. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në datën 16 mars 2021 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 6 muaj.

2.7 Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1537**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar gjyqit dt. 06.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vit e 2 muaj, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal 31.07.2019 deri në datën 09.09.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Në datën 15.09.2020 është marrë vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-ndërtimi. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për afro 1 vit e 5 muaj.

Për këtë procedim penal oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, shpjegoi në séance dëgjimore se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një vit më pas nga data e regjistrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi mbi 4 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjera. Edhe ato pak veprime hetimore janë kryer në muajin shtator 2020 dhe mandej dosja është mbajtur në dorë pa veprime deri në muajin janar 2021. Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 4 muaj.

2.8 Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr. 1525**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar për gjykim dt. 31.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vit e 2 muaj, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, dosja është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një vit më pas nga data e regjistrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi mbi 4 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për katër muaj të tjerë. Në datën 09.09.2020 janë marrë deklaratime nga shtetasi Adem Drazhi, në datën 16.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni, dhe në datën 15.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit

teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në datën 30.12.2020 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 4 muaj.

2.9 Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr 1544**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar për gjykim dt. 13.04.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit procedimit penal, 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, dosja është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjistrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi mbi 8 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për 8 muaj të tjerë. Në datën 10.09.2020 janë marrë deklarime nga shtetasi Kujtim Allushi, në datën 16.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni dhe në datën 15.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas, deri në datën 12.04.2021 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 8 muaj.

2.10 Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1539**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 24.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, dosja është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, një viti më pas nga data e regjistrimit të procedimit penal, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi mbi 4 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për katër muaj të tjerë. Në datën 16.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni dhe në datën 15.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në datën 16.12.2020 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor. Rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 4 muaj.

2.11 Në datën 02.03.2020 është regjistruar **procedimi penal 386**, për veprën penale “Organizimi i llotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, zgjidhur me marrëveshje datë 10.02.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore dhe mbajtjen e dosjes pa veprime për periudha të gjata kohe. Për një periudhë afro shtatë muajore, nga momenti i regjistrimit procedimit penal 02.03.2020 deri në datën 27.10.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për afro 11 muaj. Veprimet hetimore të kryera janë shumë të pakta dhe nuk mjustifikojnë mbajtjen e procedimit penal për një kohë të gjatë në hetim.

2.12. Në datën 16.04.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.763**, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 19.06.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për 1 vit e 2 muaj. Rezulton se prokurori i çështjes në datën 19.04.2019 ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore duka ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore Rasim Guzi të kryej veprimet hetimore brenda datës 15.06.2019. Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, nuk është respektuar ky afat, por dosja është mbajtur prej tij pa shkaqe të justifikuara deri në datën 17.02.2020, kur ka përpiluar relacionin përfundimtar për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Me mosveprimet e tij, oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi ka zvaritur hetimet e procedimit penal për 11 muaj.

2.13. Në datën 124.10.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.2136**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 19.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Për një periudhë 10 muajore, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, 24.10.2019 deri në datën 31.07.2020, dosja është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 31.07.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi për 5 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për pesë muaj të tjerë. Në datën 10.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni dhe në datën 15.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në datën 19.01.2021 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor. Rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvaritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.14. Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1521**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, pushuar në datën 07.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit procedimit penal, 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, dosja është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Në datën 31.07.2020 prokurori i çështjes ka nxjerrë urdherin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pas kësaj date procedimi penal është mbajtur edhe për 5 muaj nga oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për pesë muaj të tjerë. Në datën 08.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni dhe në datën 15.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas deri në datën 16.12.2020 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor. Rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.15. Në datën 31.07.2019 është regjistruar **procedimi penal 1532**, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a I Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 29.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal 31.07.2019 deri në datën 31.07.2020, procedimi penal është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Në datën 31.07.2020 prokurori i çështjes ka nxjerrë urdherin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pas kësaj date procedimi penal është mbajtur edhe për 5 muaj nga oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për pesë muaj të tjerë. Në datën 16.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni dhe po në datën 16.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas, deri në datën 14.12.2020 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor. Rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.16. Në datën 22.01.2020 është regjistruar procedimi penal nr.140, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, pushuar në datën 18.01.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Për një periudhë afro 6 mujore, nga momenti i regjistrimit procedimit penal 22.01.2020 deri në datën 31.07.2020, nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Në dt.31.07.2020 prokurori i çështjes ka nxjerrë urdherin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pas kësaj date procedimi penal është mbajtur edhe për 5 muaj nga oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për pesë muaj të tjerë. Në datën 10.09.2020 i është drejtuar me shkresë Bashkisë Elbasan për marrje informacioni, në datën 16.09.2020 janë pyetur disa persona si deklarues dhe po në datën 19.09.2020 është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik. Këto veprime janë kryer në muajin shtator 2020, dhe më pas, deri në datën 18.01.2021 nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor. Në rrethana të tilla, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.17. Në datën 19.06.2018 është regjistruar procedimi penal nr.1047, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, dërguar për gjykim në datën 01.03.2020

Në këtë procedim penal konstatohen zvarritje të pajustificuara dhe për periudha të gjata kohe, të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore dhe shkeljen e afateve të hetimit të caktuara nga prokurori në urdherin për kryerjen e veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për afro 1 vit e 9 muaj. Për një periudhë për afro 1 vit e 6 muaj, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore janë marrë vetëm 3 deklarime nga persona që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, si dhe është përpiluar një shkresë adresuar OSHSE dhe nuk është kryer asnjë veprim tjetër hetimor.

2.18 Lidhur me 5 procedime penale të cilët përfshihet në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në grupin e procedimeve penale për të cilat kërkohet procedimi disiplinor, Komisioni nuk konstaton zvarritje në hetimin e këtyre procedimeve penale, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Rasim Guzi.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, pas administrimit të provave të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, arriti në përfundimin se në procedimet penale, **nr.993, regjistruar në datën 03.06.2020, nr.1746 i vitit 2020, nr.82 i vitit 2020, nr.127 i vitit 2021 dhe nr.1743 i vitit 2020**, nuk evidentohen veprime apo moveprime të tij që pasjellin zvarritje në hetimin e këtyre procedimeve penale. Këto procedime penale janë hetuar nga oficerë të tjerë dhe oficeri Rasim Guzi ka kryer vetëm veprimin hetimor të përfundimit të hetimeve.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shpjegimet e vetë subjektit të procedimit disiplinor, provohet se gjatë hetimit të **16** procedimeve penale, të trajtuara më lart, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Rasim Guzi, janë shkelur kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, që disiplinon afatet e hetimit dhe dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorit. Sikurse rezulton nga aktet e dosjeve penale të sipërcituara, shumë veprime hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdherin e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 mujor që parashikon neni 323 i Kodit të Procedurës Penale. Neni 323 i K.Pr.Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.”

Ndërsa në nenin 7, pika 2 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, është parashikuar detyrimi që ka oficeri i Policisë Gjyqësore për të zbatuar urdherat

dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Sikurse u provua gjatë shqyrtimit të procedimit disiplinor, në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, për 16 procedimet penale që u trajtuan më sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, nuk ka respektuar afatet e hetimit dhe afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e çështjes.

4. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të prokurorit, nga oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi, për vetë natyrën e tyre dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuara nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, dhe nenit 7 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, mbajtja në dorë e procedimit penal, pa kryer veprime hetimore dhe kryerja e tyre jashtë afateve të caktuara nga prokurori, përbëjnë shkelje disiplinore në formën, *“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat pasjellin zvarritje të proceseve hetimore”*, parashikuara nga neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

4.1. Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Rasim Guzi, nuk i pranon ato dhe shpjegon se vonesat dhe zvarritjet kanë ardhur sepse dosjet janë mbajtur për një kohë të gjatë nga prokurorët e çështjes apo oficerë të policisë gjyqësore që i kanë patur më parë këto dosje dhe se veprimet e saj kanë qenë brenda afatit ligjor.

Këto shpjegime dhe pretendime të oficerit të policisë gjyqësore Rasim Guzi, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat në hetimin e procedimeve penale.

Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenit 7, pika 2, oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë detyrimin ligjor të zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Ndërsa në nenin 33, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale parashikohet detyrimi i Policisë Gjyqësore për të kryer detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe të njoftojë atë menjëherë mbi rezultatet e tyre. Për procedimet penale objekt i shqyrtimit të këtij procedimi disiplinor, prokurori ka caktuar veprimet hetimore që duhet të kryeshin dhe afatin brenda të cilit duhet të kryeshin nga oficeri i policisë gjyqësore, të cilat nuk janë respektuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi.

Mosrespektimi afateve të caktuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe prokurori, kryerja e veprimeve hetimore tej këtyre afateve, dhe mosnjoftimi i prokurorit, për rezultatet brenda afatit të caktuar prej tij, përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe zvarritje në hetim, në kuptimin që Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” jep për konceptin e zvarritjeve në hetim, të cilat sjellin si pasojë përgjegjësi disiplinore për oficerin e Policisë Gjyqësore.

Në thelb, afatet e hetimit të përcaktuara në Kodin e Proçedurës Penale janë afate për prokurorin. Sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, përgjegjës për hetimin e çështjes është prokurori. Ai ka përgjegjësinë për ecurinë e çështjes dhe përfundimin e saj në afatet që ka caktuar Kodi i Proçedurës Penale.

Oficeri i Policisë Gjyqësore lidhet me urdhërat e prokurorit për afatet e hetimit. Prokurori i cakton ato në bazë të një plani që ai ka për hetimin dhe përfundimin e çështjes. Për oficerin e Policisë Gjyqësore, afate të hetimit janë ato që cakton prokurori në urdhërat për kryerjen e veprimeve hetimore.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “a”, pika 2, e nenit 33, parashikon si shkelje të lehtë, “*veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje te proçeseve hetimore*”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Nevruz Ndrejoni, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljes disiplinore të kryera prej saj, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit.

Gjithashtu Komisioni i referohet dispozitave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas rradhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që, për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Rasim Guzi të japë masën disiplinore “**vërejtje me shkrim**”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me katër vota pro.

VENDOSI:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Rasim Guzi, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i jepet masa disiplinore ***“Vërejtje me shkrim”***.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Rasim Guzi, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Rasim Guzi.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI



ANËTAR

ARJAN MUÇA

Munga

ANËTAR

HARI GOGO

[Signature]

ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO

[Signature]